- D. Ç'farëdo lloj mendimi njerëzor e cila i jep spektatorit ndjenjën e dëshpërimit

165. Dobia sipas Hjumit është përcaktuar si;

- A. Një jo tendencë për një qëllim të natyrshëm
- B. Si një tendencë për një qëllim të natyrshëm
- C. Si një tendencë për një qëllim jot ë natyrshëm
- D. Si një absurd

166.Sipas Hjumit drejtësia ;

- A.Pasqyron interesin e përgjithshëm dhe jo vetjak
- B.Kënaq interesat e përgjithshme
- C.Pasqyron interesin vetjak të ç'do personi
- D. Nuk ka lidhje me interesat

167.Dobia e drejtësisë sipas Hjumit kënaq;

- A.Interesat e përgjithshme
- B.Interesat vetjake
- C.Interesat e askujt
- D.Interesat e një grupi të caktuar

168.Sipas Hjumit,drejtësisë ja jep cilësinë e një virtyti moral;

- A.Ndjenja e simpatisë
- B.Ndjenja e kënaqësisë
- C.Ndjenja e urrejtjes
- D.Ndjenja e dashurisë

169. Ne e dënojmë padrejtësinë sipas Hjumit kur;

- A.Përfshihet interesi i përgjithshëm
- B.Krijon dhembje
- C.Kur ajo krijon lumturi
- D.Kur nuk krijon dhembje

170.Sipas Hjumit burim i aprovimit moral është;

- A.Simpatia me interes vetjak
- B.Simpatia me interes publik
- C.Interesi i përgjithshëm
- D.Urrejtja

171.Sipas Kantit ne arrijmë të njohim shkaqet;

- A.Nga të prekurit
- B.Nga të nuhaturit
- C.Nga aftësia e gjykimit racional
- D.Nga të shikuarit

172.Njohja apriori;

- A.Vjen nga përvoja
- B.Nuk vjen nga përvoja
- C.Vjen nga të shikuarit
- D.Vjen nga të nuhaturit

173.Në gjykimin analitik predikati;

- A.Është i përfshirë në konceptin e subjektit
- B. Nuk është i përfshirë në konceptin e subjektit
- C.Është i njëjtë me subjektin
- D.Nuk ka lidhje me subjektin

174.Në gjykimin analitik predikati;

- A.Na jep njohje të reja rreth subjektit
- B.Nuk na jep asnjë njohje rreth subjektit
- C.Nuk na jep asnjë njohje të re rreth subjektit
- D.Nuk ka lidhje me subjektin

175. Në gjykimin sintetik predikati;

- A.Nuk përfshihet brenda subjektit
- B.Shton diçka të re në kuptimin e subjektit
- C.Nuk na jep asnjë njohje të re rreth subjektit
- D.Nuk ka lidhje me subjektin

176.Gjykimet analitike janë;

- A.Aposteriori
- B.Apriori
- C.Edhe apriori edhe posteriori
- D.As apriori as posteriori

177.Shumica e gjykimeve sintetike janë;

- A.Aposteriori
- B.Apriori
- C.Edhe apriori edhe posteriori
- D.As apriori as posteriori

178.Imperativi kategorik ka të bëjë me;

- A.Përgjithësimin e ligjit moral
- B.Kundërshtimin e moralit
- C.Veçimin e ligjit
- D.Argumentin e ligjit

179.Shprehja e Aristotelit se “Njeriu është një kafshë politike” ka kuptimin që;

- A.Njeriu është kafshë
- B.Njeriu nuk ka arsye
- C.Njeriu është qenie që përdor fjalën,që flet
- D.Njeriu nuk di asgjë

180.Si duhet të tregohet princi nga ana financiere?

- A.Ai duhet të jetë bujar për të fituar simpatinë e popullit
- B.Ai duhet të jetë herë bujar dhe herë dorshtrenguar
- C.Ai duhet të jetë doreshtrënguar
- D.Ai duhet të marrë borxhe tek princërit e tjerë

181.Si është më mirë për princin?

- A.T'ja kenë frikën
- B.Ta duan
- C.Të kenë respekt për të
- D.Nuk ka rëndësi fare se ç'farë mendojnë njerëzit

182.Cilësitë e kujt kafshe duhet të zoterojë princi?

- A.Luanit dhe dhelprës
- B.Ujkut dhe skifterit
- C.Ujkut dhe gjarpërit
- Skifterit dhe gjarpërit

183.Sipas Makiavelit, nga se nisen njerëzit kur gjykojnë?

- A.Nga përvoja
- B.Nga faktet
- C.Nga inteligjenca
- D.Nga pamja e jashtme

184.Sipas Makiavelit, nga cilat veprime të princit mund të shkaktohet urrejtja për të?

- A.Nga veprat e mira
- B.Nga veprimet e keqia
- C.Nga veprimet e mira dhe nga ato të keqia
- D.Nga asnjëri prej tyre

185.Nese dy palë jane në konflikt, sipas Makiavelit, ç'farë qëndrimi duhet të mbajë princi?

- A.Ai nuk duhet të pozicionohet në krah të asnjërës prej palëve
- B.Ai duhet të pozicionohet në krah të njërës prej palëve
- C.Princi duhet të luajë rolin e ndërmjetësit për të arritur paqen
- D.Princi duhet të marrë mendimin e popullit për mënyrën se si duhet të veprojë

186.Sipas Makiavelit, kur duhet të këshillohet princi nga këshilltarët?

- A.Ç' do herë kur këshilltarët e konsiderojnë të nevojshme
- B.Atëhere kur e kërkon situata
- C.Atëhere kur princi nuk di ti zgjidhi vetë çështjet
- D.Atëhere kur e kërkon princi

187.Sipas Makiavelit, si duhet të sillemi ndaj fatit dhe ndryshimeve të tij?

- A.Është më mirë të jemi të nxituar
- B.Është më mirë të jemi të matur
- C.Është më mirë të këshillohemi më parë me të tjerët
- D.Është më mirë të jemi të kujdesshëm

188.Sipas Dekartit, cili nga këta elementë është shpërndarë njësoj tek të gjithë njerëzit?

- A.Gjykimi i shëndoshë
- B.Smira
- C.Virtyti
- D.Dija



189.Sipas Dekartit, nga vjen ndryshimi në mendimet tona?

- A.Nga fakti se disa janë më të arsyeshëm se të tjerët
- B.Nga fakti se disa janë më të përgatitur nga të tjerët
- C.Nga fakti se mendimet i çojmë në rrugë të ndryshme
- D.Nga fakti se disa janë më të arsimuar nga të tjerët

190.Cili është kriteri i së vërtetës sipas Dekartit?

- A.Qartësia
- B.Fakti
- C.Logjika
- D.Eksperimenti

191.Dyshimi i Dekartit është dyshim;

- A.Metodik, faktik, hiperbolik
- B.Hiperbolik, metafizik, teokratik
- C.Metodik, metafizik, faktik
- D.Hiperbolik, metodik, metafizik

192.Sipas Dekartit, metodën e tij mund ta përdorin;

- A.Vetëm filozofët
- B.Ç' do person që ka dëshirë
- C.Vetëm shkencëtarët
- D.Të gjithë, përjashtuar njerëzit e paarsimuar

193.Përgjigjen për teorinë e tij Dekarti e gjen tek;

- A.Vetja

- B.Bota
- C.Njerëzit
- D.Zoti

194.Nëse për Dekartin shpirti është diçka që mendon, po trupi ç'farë është?

- A.Diçka që vjen si pasojë e mendimit
- B.Diçka që nuk mund të mendohet
- C.Diçka që nuk shprehet me anë të përmasave
- D.Diçka që ka shtrirje

195.Cili është rregulli i parë i metodës së Dekartit?

- A.Duhet nisur gjithmonë nga faktet për të kaluar tek teoria
- B.Eksperimenti është pikënisja pasi ai na jep faktet e vërteta
- C.Nuk duhet të pranohet si e vërtetë diçka që nuk është dukshëm si e tillë
- D.Baza e ç'do shkence është arsyetimi dhe logjika, dhe së pari duhet të fillojmë me mësimet e saj

196.Sipas Lokut, origjina e ideve është nga;

- A.Bota e ideve
- B.Eksperienca
- C.Zoti
- D.Uni

197.Kur themi “bari është me jeshil se pema”, sipas Lokut kemi të bëjmë me;

- A.Ide të thjeshta
- B.Ide primare
- C.Ide sekondare

D.Ide komplekse

198.Cila prej pohimeve të mëposhtëmve, sipas Lokut, është cilësi sekondare?

- A.Ngjyra
- B.Lëvizja
- C.Shtrirja
- D.Pamja

199.Tre shkallët e njohjes së Lokut janë;

- A.Njohja shqisore, demonstrative, intuitive
- B.Të imagjinuarit, të besuarit, të menduarit
- C.Njohja faktike, eksperimentale, teorike
- D.Imagjinata, arsyetimi, shkenca

200.Sipas Lokut, në gjendjen natyrore, te drejten e e gjykimit dhe ndeshkimit e ka;

- A.Vetëm ata që janë përzgjedhur
- B. Ç' do njeri
- C. Ç' do njeri, me përjashtim të atyre që janë përfshirë direkt në çështje
- D.Zoti

201.Sipas Lokut, në gjëndjen natyrore pronësia mbi tokën dhe produktet e saj është;

- A.E pakufizuar
- B.E kufizuar
- C.Në gjëndjen natyrore nuk ka fare pronësi

D.Në gjëndjen natyrore njeriu zotëron vetëm trupin e tij

202.Sipas Lokut, si antarësohet njeriu në një shtet?

- A.Duke lindur në një territor të caktuar
- B.Duke lindur nga prindër të një shteti të caktuar
- C.Duke dhënë pëlqimin e tij për tu bërë anëtar i atij shteti
- D.Duke jetuar në territorin e një shteti

203.Sipas Lokut, cili është qëllimi kryesor që i bën njëzërit të bashkohen në një shtet?

- A.Mbrojtja e jetës së tyre
- B.Nevoja për të jetuar në komunitet
- C.Nevoja për të mbështetur në një institucion në situata të vështira
- D.Mbrojtja e pronës së tyre

204. Ç'farë mund të bëjë populli, sipas Lokut, kur legjislativi nuk vepron konform qëllimeve për të cilin është zgjedhur?

- A.Populli duhet të drejtohet gjykatës
- B. Ç'është duhet të zgjidhet me marrëveshje
- C.Populli mund ta ndërrojë apo ndryshojë vetë legjislativin
- D.Kur ka konflikt midis tyre çështjen e gjykon vetëm Zoti

205.Gjendja natyrore;

- A.Prodhon të drejta sociale
- B.Është kontratë sociale
- C.Është marrëveshje
- D.Nuk prodhon të drejta sociale

206.Cilin sitem qeverisjeje përkrahte Rusoi?

- A.Demokraci e drejpërdrejtë
- B.Demokraci përfaqësuese
- C.Aristokraci
- D.Monarki kushtetuese

207.Ligji i parë natyror për Rusoin është;

- A.Njerëzit duhet të përpiqen për paqen dhe nëse ajo nuk arrihet të përgatiten për luftën
- B.Prona është një e drejtë natyrore e patjetërsueshme e njeriut
- C.Njerëzit duhet të dëgjojnë gjithmonë arsyen e tyre
- D.Asnjë prej tyre

208.Për të formuar sovрани, sipas Rusoit, njerëzit kontraktojnë me;

- A.Njëri-tjetrin
- B.Vetveten
- C.Udhëheqësin e ardhshëm
- D.Zotin

209.Sipas Rusoit, vendimet dhe ligjet bëhen duke u bazuar tek;

- A.Vullneti i përgjithshëm
- B.Vullneti i të gjithëve
- C.Vullneti i shumicës
- D.Fullneti i parlamentit

210.Sipas Rusoit, trupi politik zotëron pushtet;

- A.Absolut

- B.Të kufizuar
- C.Të përmbajtur
- D.Të përpjestuar

211.Rusoi vetë;

- A.Ishte pro dënimit me vdekje
- B.Nuk shprehet për këtë çështje
- C.Është kundër dënimit me vdekje
- D.E shqyrton por nuk jep një mendim përfundimtar

212.Sipas Rusoit, cila është e mira më e madhe që kërkon të arrijë legjislatori?

- A.Paqja dhe begatija
- B.Lumturia dhe mireqënia
- C.Liria dhe barazia
- D.Drejtësia dhe vityti

213.Rusoi i ndan ligjet në;

- A.Civile, proveduriale. penale
- B.Politike, civile, kriminale
- C.Civile, penale, ndërkombëtare
- D.Natyrore, politike, civile

214.Sipas Rusoit ligjin e harton;

- A.Legjislatori
- B.Qeveria
- C.Parlamenti
- D.Populli

215.Kontrata sociale ;

- A.Shpreh vullnetin vetëm të njëjës palë
- B.Shpreh vullnetin e palëve përfshirëse
- C.Nuk shpreh marrëveshje
- D.Është vetëm individuale

216.Sipas Rusoit, prona fitohet me ane të;

- A.Punimit të saj
- B.Rrethimit të saj
- C.Marrëveshjes me të tjerët
- D.Me anë të pushtimit

217.Sipas Hyserlit, kriza e njeriut european vinte sepse;

- A.Shkenca propagandonte metodën e shkencave natyrore duke mohuar mundësinë e shkencës së shpirtit
- B.Teoritë shkencore nuk po e shpjegonin dot më realitetin e botës
- C.Teoritë shkencore ishin në dnryshim të vazhdueshem
- D.Njeriu braktisi zotin dhe ju drejtua shkencës

218.Ne filozofinë e tij, Hyserli e vë theksin në rradhë të parë tek;

- A.Logjika
- B.Arsyeja
- C.Përvoja
- D.Njeriu

219.Thënien e Dekartit, “unë mendoj” Hyserli e bën;

- A.Unë mendoj diçka
- B.Unë mendoj mendimin
- C.Unë mendoj mendjen
- D.Unë mendoj realitetin

220.Fenomenologjia e Hyserlit pranon se:

- A.Mund të ndahen fenomenet nga akti i vëzhgimit
- B.Fenomenet duhet të ndahen nga akti i vëzhgimit
- C.Nuk mund të ndahen fenomenet nga akti i vëzhgimit
- D.Asnjë prej tyre

221.Për Hyserlin, ndërgjegjia është;

- A.Qëllimore
- B.Rastësore
- C.Objektive
- D.E paqëndryshme

222.Me Epoche, Hyserli kupton;

- A.Analizën paraprake të çdo fenomeni
- B.Ndarjen e botës fenomenale nga ajo noumenale
- C.Grupimin e të gjithave fenomeneve pa i vlerësuar paraprëkisht ato
- D.Ndarjen e njeriut nga bota fenomenale

223.Metoda kryesore që përdori Hyserli në filozofinë e tij është;

- A.Reduktimi
- B.Analiza



- C.Eksperimenti
- D.Vëzhgimi

224.Për Hyserlin bota njerezore ka të bëjë me;

- A.Formen fillestare të përvojës dhe përjetimin parashkencor
- B.Harmonizimin e shkencës me praktikën
- C.Mohimin e shkencës dhe lindjen e besimit
- D.Instiktet dhe vullnetin për jetë

225.Sipas Shopenhaurit, një jetë e lumtur varet nga;

- A.Shuma e kënaqesive të shijuara
- B.Shuma e të keqijave dhe dhimjeve të shmangura
- C.Suksesi dhe karriera
- D.Miqësia dhe opinioni i të tjerëve

226.Sipas Shopenhauerit, një nga gjërat që duhet të bëjë njeriu për të qenë i lumtur është;

- A.Të ketë sa më shumë miq dhe të kujdeset për ta
- B.Duhet të ketë sa më shumë synime në jetë
- C.Duhet të punojë për tu bërë sa më i pasur
- D.Duhet të kufizojë sa më shumë synimet, përfytyrimet dhe marrëdhëniet me të tjerët

227.Vetmia, për Shopenhauerin, tregon;

- A.Egoizmin dhe moshoqërimin e njeriut
- B.Problem përshatjeje dhe praninë e shqetësimeve shpirtërore
- C.Vetëmjaftueshmerinë e njeriut
- D.Edhe A edhe B edhe C

228.Sipas Shopenhauerit, a duhet të pajtohemi me një mik pasi kemi prishur marrëdhëniet për faj të tij?

- A.Jo, sepse ai do ta përsërisë të njëjtin veprim herët a vonë
- B.Po, sepse falja tregon zemërgjerësi dhe supremacy
- C.Po, sepse miqësia është një nga gjërat më të rëndësishme
- D.Edhe B edhe C

229. Sipas Shopenhauer, në një situatë kur nuk dimë se si të veprojmë, kë duhet të marrim si model sipas Shopenhauerit?

- A.Filozofët dhe njerëzit e ditur
- B.Figurat e mëdha historike
- C.Fjalës dhe urdhëresave të zotit
- D.Asnjerës prej tyre

230.Sipas Shopenhauerit, si duhet ti trajtojmë çështjet tona personale?

- A.Duhet ti mbajmë sa më të fshehta që të mundemi
- B.Mund t'ia themi miqve pasi kjo tregon besim dhe forcon miqësinë
- C.Kur të fshehtat bëhen të demshme kur zbulohen, ne duhet ti bëjmë publike që në fillim
- D.Asnjëra prej tyre

231.Nga cili prej këtyre filozofëve u ndikua me shumë Sartri?

- A.Platoni
- B.Rusoi
- C.Hegeli
- D.Marksi

232.Thënia e Sartrit, “ekzistenca paraprin esencën”, do të thotë;

- A.Ka një natyrë njerëzore të paracaktuar
- B.Qenia njerëzore ka një qëllim të përcaktuar
- C.Nuk ka një natyrë njerëzore të paracaktuar
- D.Ne mund ta paracaktojmë natyrën e njeriut

233..Kur njeriu zgjedh, sipas Sartrit, ai mban përgjegjësi për;

- A.Vetëm për veten e tij
- B.Për veten e tij dhe për të tjerët
- C.Për veten dhe për ata që ndikohen nga zgjedhja e tij
- D.Asnjëra prej tyre

234.Njeriu, sipas Sartrit, është;

- A.Tërësia e veprimeve të tij
- B.Tërësia e gjërave që ka realizuar dhe atyre që mund të realizonte
- C.Një krijesë e zotit e krijuar në bazë të imazhit të tij
- D.Një qenie që ka një thelb i cili mbetet i pandyshuar pavarësisht veprimeve që bën njeriu

235. Ç ’farë thotë Sartri për kuptimin e jetës?

- A.Jeta ka një kuptim dhe njeriu duhet ta zbulojë atë
- B.Jeta nuk ka një kuptim
- C.Jeta ka kuptim por njeriu nuk mund ta zbulojë dot atë
- D.Jeta nuk ka kuptim por është njeriu që i jep asaj kuptime

236.Duke mohuar ekzistencën e Zotit, Sartri njëkohësisht;

- A.Shpreh pamundësinë e pasjes së një morali
- B.Nuk e mohon ekzistencën e moralit
- C.E bën njeriun të papërgjegjshëm për vendimet e veta
- D.Asnjëra prej tyre

237.Cili është kuptimi i objekteve, sipas Sartrit?

- A.Objektet kanë atë kuptim që i jep njeriu
- B.Objektet kanë kuptim në vetvete pavarësisht qëndrimit që mban njeriu
- C.Objektet kanë atë kuptim që u jep shumica e njerëzve
- D.Objektet nuk kanë fare kuptim

238.Përsosuria sipas Kantit i drejtohet vetëm;

- A.Emocioneve
- B.Aftësisë estetike
- C.Intelektit
- D.Bukurisë fizike

239. E bukura sipas Kantit i drejtohet ;

- A.Intelektit dhe emocioneve
- B.Vetëm emocioneve
- C.Vetëm arsyes
- D.Vetëm shpirtit

240.Gjykimi që përfshin të veçantën brenda vetes sipas Kantit quhet;

- A.Gjykim jo përcaktues
- B.Gjykim determinant
- C.Aposteriori
- D.Gjykim sintetik

241.Sipas Kantit gjykimi i shijes është;

- A.Një gjykim njohës
- B.Logjik
- C.Jo logjik
- D.Me bazë objektiven

242.Sipas Kantit,përfaqësimet e dhëna në një gjykim;

- A.Nuk mund të jenë empirike
- B.Nuk mund të jene estetike
- C.Mund të jenë empirike e për rrjedhojë estetike
- D.Nuk i referohen objektit

243.Sipas Kantit interes quhet;

- A.Kënaqësia jonë që lidhet me përfaqësimin e ekzistencës reale të objektit
- B. Kënaqësia jonë që nuk lidhet me përfaqësimin e ekzistencës reale të objektit
- C.Pakënaqësia rreth diçkaje
- D.Ajo që nuk ka lidhje me kënaqësinë

244.Sipas Kantit e pëlqyeshme është ;

- A.Ajo që thjesht e kënaq njeriun
- B.Ajo që përmbush kënaqësinë e njeriut
- C.Ajo me të cilën bashkëngjitet një dobi objective
- D.Ajo që nuk ka lidhje me kënaqësinë

245. Sipas Kantit e mirë është;

- A.Ajo që thjesht e kënaq njeriun
- B.Ajo që përmbush kënaqësinë e njeriut
- C.Ajo me të cilën bashkëngjitet një dobi objektive
- D.Ajo që nuk ka lidhje me dobinë

246.Sipas Kantit gjykimi i shijes;

- A.Është estetik
- B.Nuk është estetik
- C.Është pa objekt
- D.Është pa subjekt

247.Sipas Kantit,e bukur është ajo që;

- A.Përfaqësohet si një objekct i një kënaqësie universal
- B.Përfaqësohet si një objekct i një kënaqësie individuale
- C.Nuk përfaqësohet si një object I një kënaqësie
- D.Që nuk ka lidhje me kënaqësinë

248. Sipas Kantit,në gjykimin e shijes universaliteti i kënaqësisë;

- A. Përfaqësohet si gjykim subjektiv
- B. Përfaqësohet si gjykim objektiv
- C. Nuk përfaqësohet si gjykim
- D. Nuk pranohet si gjykim

249.Sipas Kantit gjykimi i kulluar i shijes;

- A. Është i varur nga emocioni
- B. Është pavarur nga emocioni
- C. Nuk ndikohet nga emocioni
- D. Ka shmangie nga interesi

250. Imperativi kategorik i Kantit flet për;

- A. Veprim të thjeshtë
- B. Ligjin moral
- C. Intuitën
- D. Ndijimet

251. Imitimi krejtësisht i saktë;

- A. Është qëllimi i artit
- B. Është qëllimi i njeriut
- C. Nuk është qëllimi i artit
- D. Nuk ka lidhje me artin

252. Temperatura morale në krijimin e një vepre arti sipas Taine;

- A. Ka të bëjë me prodhimin natyror
- B. Ka të bëjë me prodhimin shpirtëror
- C. Ka të bëjë me temperaturën fizike
- D. Ka të bëjë me mjedisin natyror

253. Sipas Hegelit individi;

- A.Është i ndërgjegjshë për lirinë e vet
- B.Nuk e shpreh qartë lirinë e tij përmes veprimeve të vullnetshme
- C.Nuk është i ndërgjegjshëm për lirinë e tij
- D.Është i izoluar

254.E gabuara sipas Hegelit qëndron në;

- A.Harmoninë ndërmjet vullnetit individual dhe atij të përgjithshëm
- B.Thyerjen e harmonisë ndërmjet vullnetit individual dhe atij të përgjithshëm
- C. Injorimin e vullnetit individual dhe atij të përgjithshëm
- D.Pavullnetshmëri

255.Sipas Hegelit morali është i përqëndruar më shumë;

- A.Tek e mira
- B.Thjesht tek bindja e ligjeve
- C.Zbatimi i marrëveshjeve
- D.Tek e keqja

256.Sipas Hegelit morali është një process dialektik ku teza ;

- A.Është e drejta konkrete
- B.Është e drejta e përgjithshme
- C.Është abstraktja
- D.Është e drejta abstrakte e çdo individi

257. Sipas Hegelit antiteza është;

- A.E drejta konkrete
- B.E drejta e përgjithshme



- C.Është abstraktja
- D.Është morali

258.Shteti sipas Hegelit është;

- A.Tezë
- B.Antitezë
- C.Sintezë e familjes dhe e shoqërisë civile
- D.Shoqëria

259. Shteti sipas Hegelit është;

- A.Thjesht ide
- B.Ideja e shpirtit në formën e jashtme të tij
- C.Ideja e trupit
- D.Morali

260.Funksioni i shtetit sipas Hegelit është;

- A.Lëshimi i urdhrave arbitrare
- B.Të bëjë marrëveshje
- C.Të frenojë nëpërmjet ligjeve sjelljet racionale
- D.Të rrisë nëpërmjet ligjeve të tij sjelljet racionale

261.Në procesin dialektik të Hegelit njohja e Absolutit është;

- A.Teza
- B.Antiteza
- C.Trupi
- D.Sintezë e shpirtit objektiv dhe subjektiv

262.Sipas Hobsit njerëzit nga natyra;

- A.Janë të barabartë midis njëri-tjetrit
- B. Janë të pabarabartë midis njëri-tjetrit
- C.Kanë morale të ndryshme
- D.Bëjnë gjëra të pabarabarta

263.Pabarazia sipas Hobsit e ka bazën tek;

- A.Natyrorja
- B.Dëshirat
- C.Shpirti
- D.E drejta civile

264.Sipas Hobsit njerëzit në gjendjen e natyrës;

- A.Kanë dëshirën për të dëmtuar
- B.Nuk kanë vullnetin për të dëmtuar
- C.Kanë kontrata sociale
- D.Respektojnë kontratat sociale

265.Sipas Hobsit njeriu duke e menduar veten mbi të tjerët;

- A.Nuk i jep vetes të drejtën për të bërë atë që mendon
- B. I jep vetes të drejtën për të bërë atë që mendon
- C.Nuk sfidon respektin që mendon se i takon
- D.Nuk sfidon nderin që mendon se i takon

266.Vuullneti i njeriut për të çenuar të tjerët sipas Hobsit rrjedh;

- A.Nga lavdia reale
- B.Nga virtyti
- C.Nga vlerësimi i vërtetë
- D.Nga lavdia boshe

267.Sipas Hobsit në gjendjen e natyrës njerëzit;

- A.Kanë të drejtën për të bërë gjithçka
  - B.Nuk kanë të drejtën për të bërë gjithçka
  - C.Kanë të drejtën për të bërë gjithçka pasi të angazhohen në marrëveshje
  - D.Veprojnë sipas marrëveshjeve
- PS:A

268. Diktati i nëntë i ligjit natyror është;

- A.Të drejtat që njerëzit kërkojnë për veten nuk i pranojnë për të tjerët
- B. Që ekzistojnë vetëm të drejta individuale
- C.Që ekzistojnë vetëm të drejta të përgjithshme
- D. Të drejtat që njerëzit kërkojnë për veten duhet t'i pranojnë për të tjerët

269.Sipas Rols,parimet e drejtësisë kanë të bëjnë me ;

- A.Zgjedhjen e lirisë në mënyrë të pabarabartë që do të bënin njerëzit
- B.Zgjedhjen e lirisë në mënyrë të barabartë që do të bënin njerëzit
- C.Kufizimet e lirisë së njerëzve në mënyrë të pabarabartë
- D.Dënimet e njerëzve

270.Në drejtësinë si paanësi sipas Rols,pozita fillestare e barazisë;

- A.I përgjigjet jo gjëndjes natyrore
- B.I përgjigjet marrëveshjeve
- C.I përgjigjet gjëndjes natyrore
- D.I përgjigjet ligjeve

271. Ideja e pozitës fillestare sipas Rols ka të bëjë me;

- A. Vendosjen e procedurave të anshme
- B. Me mos pranimin e asnjë parimi
- C. Me pranimin e parimeve jo të drejta
- D. Me pranimin e ç' do parimi që të jetë i drejtë

272. Formulimi i parë i parimeve të drejtësisë ka të bëjë me;

- A. Jo ç' do person duhet të ketë një të drejtë të barabartë për gëzimin e lirisë
- B. Ç' do person duhet të ketë një të drejtë të barabartë për gëzimin e lirisë
- C. Privimin e lirisë
- D. Liri të papajtueshme të individit në raport me të tjerët

273. Pabarazitë sociale sipas Rols duhet të organizohen në mënyrë të tillë që;

- A. Të mendohet dhe të arsyetohet se këto janë në të mirë të gjithsecilit
- B. Të mendohet se këto janë në të mirë të disa individëve
- C. Të arsyetohet dhe të mendohet se këto janë në të keq të gjithsecilit

274. Parimet e drejtësisë shërbejnë për;

- A. Për të mos bërë shpërndarje të përfitimeve sociale dhe ekonomike
- B. Për të rregulluar shpërndarjen e përfitimeve sociale dhe ekonomike
- C. Për të mos caktuar detyra për shpërndarjen e përfitimeve social-ekonomike
- D. Për të mos caktuar të drejta për shpërndarje e përfitimeve social-ekonomike

275. Padrejtësia sipas Rols ka të bëjë me;

- A. Shpërndarjen e parbartë të vlerave sociale
- B. Shpërndarjen e barbartë të vlerave sociale
- C. Shpërndarjen e vlerave sociale në të mirë të të gjithëve
- D. Zbatimin e ligjeve

276. Konceptimi i përgjithshëm i drejtësisë;

- A. Imponon rrezik mbi llojin e pabarazive të lejueshme
- B. Nuk kërkon përmirësimin e pozitës së të gjithëve
- C. Imponon padrejtësinë
- D. Nuk imponon asnjë rrezik mbi llojin e pabarazive të lejueshme

277. Sipas Mill, të mohosh do të thotë;

- A. Të mendosh se jemi të gabueshëm
- B. Të mendosh se bazohemi tek shqisat
- C. Të mendosh se jemi të pagabueshëm
- D. Të mendosh pa arsytuar

278. Sipas Mill mendimet;

- A. Nuk e humbasin imunitetin e tyre
- B. E humbasin imunitetin e tyre në rrethanat kur shprehin nxitje për dëme
- C. E humbasin imunitetin e tyre në rrethanat kur shprehin dobishmëri
- D. E humbasin imunitetin e tyre në rrethanat kur shprehin virtyte

279. Sipas Mill, bashkjetesa ka të bëjë me;

- A. Mos zbatimin e një linje sjelljeje kundrejt të tjerëve
- B. Me zbatimin e një linje sjelljeje kundrejt të tjerëve
- C. Me zbatimin e një sjelljeje krejtësisht individuale
- D. Përvoja dhe jo sjellje

280. Shoqëria gëzon juridiksion mbi individin;

- A. Kur sjellja e individit nuk cënon intereset e të tjerëve
- B. Kur sjellja e individit nuk është e dëmshme për intereset e të tjerëve
- C. Kur sjellja e individit cënon pa paragjykim interesat e të tjerëve
- D. Kur sjellja e individit cënon me paragjykim intereset e të tjerëve

281. Sipas Mill, për të çuar përpara të mirën e të tjerëve;

- A. Nevojitet pakësim i mundimit pa interes
- B. Nevojitet rritje e mundimit pa interes
- C. Nuk nevojitet rritje e mundimit pa interes
- D. Nuk ka lidhje me mundimin me apo pa interes

282. Metoda pragmatiste ka të bëjë me;

- A. Përpjekjet për të interpretuar nocionin duke vëzhguar pasojat praktike të tij
- B. Idealizmin
- C. Empiricizmin
- D. Utopizmin

283. Pragmatizëm do të thotë;

- A. Ide
- B. Arsyë
- C. Nohje empirike
- D. Veprim

284. Sipas Xheims, për të arritur në mendimet tona qartësi mbi një objekt;

- A.Nuk nevojitet të shqyrtojmë pasojat e llojit praktik që sjell objekti
- B.Nevojitet të shqyrtojmë pasojat e llojit praktik që mund të sjellë objekti
- C.Nuk duhet të presim ndijime
- D.Nuk duhet të presim reagime

285.Parimi i Përsit ka të bëjë me;

- A.Mendimet tonë mbi objektin për aq kohë sa ai mendim ka kuptim pozitiv
- B.Mendimet tonë mbi objektin për aq kohë sa ai mendim ka kuptim negative
- C.Idealizmin
- D.Utopizmin

286.Pragmatisti largohet nga;

- A.Mjaftueshmëria
- B.Konkretja
- C.Zgjidhjet jo verbale
- D.Abstraksioni

287.Pragmatisti largohet nga;

- A.Parimet e lëvisshme
- B.Sistemet e hapura
- C.Sistemet e kundërshtueshme
- D.Sistemet e mbyllura e të pakundërshtueshme

288.Pragmatisti kthehet nga;

- A.Abstraktja
- B. Konkretja dhe forca
- C.Dobësia
- D. Pamjaftueshmëria

289. Pragmatizmi ka të bëjë me;

- A. Mundësi të hapura përkundrejt dogmës
- B. Mundësi të mbyllura përkundrejt pretendimit për të vërtetën absolute
- C. Mundësi të mbyllura përkundrejt artificialitetit
- D. Mos heqje dorë nga inati racionalist

290. Të zbatosh metodën pragmatiste sipas Xhejms do të thotë;

- A. Të qëndrosh spektator ndaj ndonjë fjale që mbyll kërkimin
- B. Të mos qëndrosh spektator ndaj ndonjë fjale që mbyll kërkimin
- C. Të jesh indiferent ndaj veprimit
- D. Të jesh pa forcë

291. Pragmatizmi ;

- A. Pajtohet vetëm me nominalizmin
- B. Pajtohet vetëm me utilitarizmin
- C. As a as B
- D. Pajtohet edhe me nominalizmin edhe me utilitarizmin

292. Pragmatizmi ;

- A. Pajtohet vetëm me pozitivizmin
- B. Pajtohet vetëm me utilitarizmin
- C. As a as B
- D. Pajtohet edhe me pozitivizmin edhe me utilitarizmin

293. Sipas Xhon Djuit, mënyrat e shprehjes së bindjes dhe adhurimit janë;



- A.Të ngjashme
- B.Të ndryshme
- C.Të kundërta
- D.Pa lidhje me njëra tjetrën

294.Sipas Djuit motivet morale që janë kërkuar dhe shfrytëzuar;

- A.Kanë unitet
- B.Nuk kanë unitet
- C.Janë të njëjta
- D.Asnjëra prej tyre

295.Fetë e rëndësishme sipas Djuit;

- A.Nuk kanë pasur lidhje me kushtet e kulturës shoqërore
- B.Nuk kanë pasur lidhje me kulturën ku kanë jetuar njerëzit
- C.Kanë pasur lidhje me kushtet e kulturës shoqërore
- D.Nuk e vlerësojnë kulturën shoqërore

296. Sipas Djuit feja;

- A.Ka karakter individual
- B.Është në njëjës
- C.Është term i llojit që ilustron në librat e logjikës
- D. Është term kolektiv

297.Sipas Taine arti;

- A.Është thjesht imitim
- B.Nuk është thjesht imitim
- C. Kundërshton imitimin
- D.Është e kundërta e imitimit

298. Në krijimin e veprës së artit përfshihet;

- A.Vetëm prova e përvojës
- B.Vetëm prova e arsyetimit
- C.Asnjëra prej tyre
- D.Edhe A edhe B

299.Në krijimin e një vepre arti;

- A.Ndikon mjedisi dhe gjendja shpirtërore
- B.Nuk ndikon mjedisi dhe gjendja shpirtërore
- C.Ndikon vetëm imitimi
- D.Ndikon vetëm edukimi shkollor

300.Filozofia ;

- A.Është shkencë
- B.Është sjellje
- C.Ka element të përbashkët me shkencat e tjera
- D.Nuk ka asnjë element të përbashkët me shkencat e tjera